Në përputhje me to deklaroj se asnjë zyrtar i përcaktuar në **Kreun III, Seksioni II** të Ligjit Nr. 9367, datë 7.4.2005, dhe në këtë deklaratë, nuk zotëron interesa private në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë me personin juridik që unë përfaqësoj.

Data e dorëzimit të deklaratës _____

Emri, Mbiemri, Nënshkrimi

Vula _____

Shtojca 8

[Shtojcë për tu plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PRANIMIT/KUALIFIKIMIT

Ofertuesi duhet të deklarojë se:

- a) Është i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit. Në rastin kur ofertuesi është një organizatë jofitimprurëse, duhet të deklarojë se është i regjistruar si person juridik, sipas Ligjit Nr.8788, datë 07.05.2001 “Për Organizatat jo Fitimprurëse”.
- b) nuk është në proces falimentimi, (statusi aktiv)
- c) nuk është dënua për shkelje penale, në përputhje me Nenin 45/1 të LPP,
- ç) nuk është dënua me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale.
- d) ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e tatimeve e të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi.

Edhe Ofertuesi i huaj duhet të deklarojë se i plotëson të gjitha kërkesat e renditura më sipër nëpërmjet paraqitjes së një vetëdeklarate me shkrim.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentat në gjuhë të huaj duhet të shoqërohen me një përkthim të noterizuar në gjuhën shqipe.

Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vetëdeklaratën e lartpërmendur.

Kriteret e Përgjithshme për Pranim, nuk duhet të ndryshohen nga autoritetet kontraktore.

Këto kritere duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 5.

Nëçdo rast, autoriteti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër.

Vec kesaj, nëse oferta dorëzohet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, duhet të dorëzohen:

- a. Marrëveshja e noterizuar sipas së cilës bashkimi i operatorëve ekonomikë është krijuar zyrtarisht;
- b. Prokura e posaçme.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Formularin e Ofertës, sipas Shtojcës 1 ose Shtojcës 2 (në rastin e procedurave të prokurimit për furnizimin me karburante, gazoil, benzol dhe karburant për ngrohje);

b. Deklarate për paraqitje oferte të pavaruar, sipas Shtojcës 2/1;

c. Deklaratë mbi garantimin e zbatueshmërisë së dispozitave ligjore në marrëdhëniet e punës sipas Shtojcës 5/1;

ç. Deklaratë mbi përmbushjen e specifikimeve teknike, sipas Shtojcës 6;

d. Deklaratën mbi Konfliktin e Interesit sipas Shtojcës 7;

dh. Vërtetimin që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri.

e) Sigurimin e ofertes leshuar nga shoqëri sigurimi të licensuara nga autoritetet kompetente, i cili duhet të jete 2% e vleres se perlogaritur te kontrates.

2. Për të provuar përmbushjen e kapaciteteve të mëposhtme, Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Kapaciteti ligjor/profesional i operatorëve ekonomikë:

Sipas kriterëve të përgjithshme të pranimit /kuaklifikimit sipas shtojcës 8 të DST-ve

2.2. Për kapacitetin ekonomik dhe financiar:

Vlerësimi i gjendjes ekonomike e financiare të Operatorit Ekonomik do të kryhet bazuar në deklaratat e dokumentat e mëposhtme:

- Operatori ekonomik duhet të paraqesë xhiron mesatare të 3 viteve të fundit (2018,2019,2020), e cila të jetë jo më e ulët se 1 100 000 leke
- Operatori ekonomik duhet të paraqesë kopje të vërtetuar bilanceve të 3 (tre) viteve : 2018, 2019, 2020 të vulosura nga organet tatimore
- **Vërtetim për shlyerjen e taksave vendore** të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin, 2020 sipas Ligjit Nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” (i ndryshuar);

2.3 Për kapacitetin teknik:

- a) Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit, në vlerën jo më pak se 40% të vlerës së fondit limit. Këto furnizime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:
 - b) Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me ent publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë kontrata të nënshkruara të shoqeruara me: vërtetim për realizimin e tyre ose me fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.
 - c) Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë vetëm fatura përkatëse tatimore të shitjes ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.
- Operatori ekonomik ofertues të paraqesë certifikatat që vërteton se sistemi i kontrollit të cilësisë së ofertuesit është sipas standartit

- Operatori ekonomik ofertues te paraqese certifikatat qe vërteton se sistemi i kontrollit të cilësisë së ofertuesit është sipas standartit
- a) *ISO 9001:20015 mbi “Sistemet e menaxhimit cilësisë”, lëshuar nga institucionet zyrtare të akredituar për këtë qëllim. Certifikata kërkohet të jetë e vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit.*
- b) *ISO 22301-2012 Sistemi i menaxhimit te vazhdueshmerise se biznesit lëshuar nga institucionet zyrtare të akredituar për këtë qëllim. Certifikata kërkohet të jetë e vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit.*
- c) *Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të paraqesë Çertifikatë ISO 28001-2007 mbi “Sistemet e menaxhimit të sigurisë për zinxhirin e furnizimit“ (e vlefshme dhe e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë). (Në rastet e bashkimit të operatorë veekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO).*

Certifikatat duhet te jene te leshuara nga organizmat e vleresimit te konformitetit, te cilat jane te akredituara nga Drejtoria e pergjithshme e akreditimit (DPA), ose nga organizmat nderkombetare akreditues te njohur nga Republika e shqiperise.

-Operatori ekonomik duhet të ketë në stafin e tij 1 (një) inxhinier tekstili. Per vertetimin e kesaj pike, ofertuesi duhet te paraqesë: diplomën dhe kontraten e tij te punes.

- Operatori ekonomik duhet të paraqesë për mallrat objekt prokurimi katalog dhe / ose skedë teknike sipas standarteve ne specifikimet teknike nga firma prodhuese, në mënyrë që të verifikohet pajtueshmëria e specifikimeve teknike të mallrave të ofertuara me specifikimet teknike të kërkuara nga AK.

-Objekti i aktivitetit te OE ne QKB, duhet te perfshije dhe mallrat e kerkuara ne ftesen per oferte.

-Ofertuesit duhet te paraqesin dokumentacionin perkates qe vërteton se mallrat objekt prokurimi jane ne perputhje me standartet e meposhteme) :

1. Mushama shiu standarti EN 343 klasi 3:1
2. Jelekfosforeshent, standarti SBEN 471

-Ofertuesi ne rast se nuk eshte prodhues per artikujt e lartepemendur, te paraqese Autorizim nga Prodhuesi, ose distributor i autorizuar, i cili merr persiper te furnizoje Ofertuesin me artikujt objekt prokurimi. Ne rastin e distributorit te autorizuar te paraqitet edhe dokumenti qe vërteton lidhjen e distributorit te autorizuar me firmen prodhuese. (Autorizimi te jete i perkthyer dhe i noterizuar, nese nuk eshte ne gjuhen shqipe).

- Operatori ekonomik ofertues, në ditën dhe orën e caktuar për hapjen e ofertave, pranë Autoritetit Kontraktor, Drejtoria e Prokurimeve, N.K.P Durres, duhet të paraqesë të paketuara nga nje moster për secilin nga zërat e mallrave objekt prokurimi dhe ato duhet te jene te mbyllura ne nje kuti jo transparente te vulosur me vulen e operatorit ekonomik.

Autoriteti Kontraktor ka të drejtën e kontrollit të mostrave të sjella me përputhshmerinë e specifikimeve të kërkuara dhe te kryeje analizat e nevojshme laboratorike nese do te shihet e arsyeshme.

Mos plotesimi i kriterëve të mesiperme nga ana e Subjektit Ofertues është kusht për skualifikim.

(të plotësohet nga autoriteti kontraktor)

Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mosdorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.

Shtojca 9

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

SPECIFIKIMET TEKNIKE

Specifikimi i Materialeve, Skicimet, parametrat teknik etj:

Përshkrimi i të dhënave teknike të mallrave objekt prokurimi të përshkruara sa më saktë dhe në mënyrë të plotë, duke krijuar kushte për konkurrim të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve. Kur është e mundur, specifikimet teknike duhet të përcaktohen në mënyrë të tillë që të kuptohen nga personat me aftësi të kufizuara.

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

Përshkrimi i mallrave

SASIA DHE GRAFIKU I LËVRIMIT

Sasia e mallit që kerkohet:

Nr	Emërtimi i Artikujve	Njësi	Sasi	Çmimi	Vlera
1	Kostume pune burrash	palë	20		
2	Përparese doku grash	copë	60		
3	Xhup pune me logo	copë	66		
4	Mushama shiu	copë	50		
5	Bluze verore	copë	50		
6	Çizme gome	copë	101		
7	Jelek pune	copë	200		
8	Sapuna aromatik	copë	1500		
9	Kominoshe pune me logo verore	copë	50		
10	Kominoshe pune me logo dimerore	copë	50		
11	Doreza	palë	1000		
12	Këpucë pune	palë	30		

Vlera neto pa tvsh : 1.200. 000 leke

Pra, vlera limit për Furnizim dhe vendosje goma me tvsh është: **1.440.000 leke**

SPECIFIKIMET TEKNIKE

1) **Mushama shiu me shirita fosforeshent material I trashe (logo)**

Tekstil i gomuar (mos pershkueshmeria e ujit 100%)

Ngjyra: **E Verdhe floreshente**

Masa m²: 180± 10 gram

Trashësia: 0.3 ±0.05mm

Qëndrueshmëria e ngjyrës në larje 30°C: Nota 5

Thurja : Garniturë Përbërja fibrore: 62 Polyester + 38% Polyamid.

Materiali te jete element tekstil sintetik i gomuar kundra ujit. Pelerina do te jete e gjate poshte gjurit, me munge te gjata dhe me kapuç.Pjesa ballore me mbyllje me zinxhir te fshehte, i cili nuk duhet te shkoije deri ne fund (mbi 20 cm pa shkuar ne fund ne vareti te masave) me ballome me gjeresi 6cm dhe me 3 (tre) susta syze metalike me diameter 10 mm me dy xhepa te pjerret me fileto, ku gjeresia e filetos 3.5-4cm dhe pjerresia e xhepit ne gjatesi 19-20 cm ngjyre blu.Krahët klasike me dy shirita floreshente rreth krahut me gjeresi 5cm dhe e baraslarguar me distance 5 cm.Kapuci duhet te pershkruhet nga nje kordon rreth kapucit i futur brenda i nje te perthyere 1 cm.Pjesa fundore klasike me nje perthyerje 2 cm. Pjesa e gjoksit dhe pjesa mbrapa ne shpatulla (stopani) duhe te bashkohen me pjeset e mengeve me dy tegela me gjeresi 8-10 mm. te stampohet logo ne shpine.

2) **Kostum pune burrash (xhakete+pantallona) (logo)**

a) *Xhaketa*

Materiali 35% pambuk dhe 65% poliester,tekstil, i tezgjahur,me thurje sarzh 2/1, cilesia e larte. Ne pjesen e perparme siper te kete ne te dy anet nga nje xhep me gjersi 18 cm bashke me kapakun ku kapaku vete eshte 6 cm bashke me fileto, pllak me kapak te cilet kane nje fileto ngjyre jeshile me e celet me gjersi 0.8 mm, ndersa ne pjesen e poshtme dy xhepa pllak me kapak.Mberthimim i kapakeve te behet me butona te zinj me diameter 1.5 mm. Mberthimi ne pjesen e pare te hapur te jete me butona po te zinj me dimesion 1.5 mm. Xhaketa eshte e pajisur me stopan ne supe para dhe shpine mbrapa ku vjen asimetrice si ne pjesen para dhe ne pjesen mbrape duke filluar nga jaka dhe varet deri ku bashkohet me pjeset e mengeve me ngjyre jeshile me e celet, ku ndarja e stopanit me pjesen tjeter behet me nje fileto 0.3 mm ngjyre bezele. Menget jane te pajisura me mansheta me gjersi 4.5 cm e pajisur me 2 percina per regjistrim.Ne pjesen e kurriz te stampohet logoja.Gjatesia e xhaketes do te jete sipas standarteve te xhaketave te kostumeve klasike dhe jo e shkurter.Xhaketa do te jete ngjyre **e verdhe floreshente** .ne pjesen e majte para dhe ne shpine do te jete logoja e ndermarrjes.

Karakteristikat e tekstilitduhettejene:

Dendesia e bazes dhe indit: B= 282 +,- 2 f/10 cm; I= 202+,-2 f/10 cm

Qendrueshmeria dhe elasticiteti: $B= 1663 \text{ N}$ $\varepsilon =71\text{mm}$
Qendrueshmeria ne keputje sipas bazes dhe indit: $I=542 \text{ N}$ $\varepsilon = 41\text{mm}$
Percaktimi i mases: $394,2 \text{ g/m}^2$
Trashesia : 0.72 mm
Lageshtira : 5%
Rezistenca e ngjyres ne larje: 40 grade C Nota 3
Percaktimi i hollesise se fillit: $NmB=11.5/1$, $NmI=23.4/1$
Llojiithurjes: Diagonal Sarzh 2/1

b) Pantallona

Materiali 35% pambuk dhe 65% poliester, tekstil, itezgjatur, methurjesarzh 2/1, cilesia e larte. Nepjesenballore do teketedyxhepatepjerret, ne pjesenanesoresipergjurit do ketedyxhepate dale tethelle me kapake me gjersi 20 cm dhe lartesi 22.5 cmbashke me kapakunkuvetekapaku me gjersi 7 cm bashke me filetonjeshile me tecelet me gjersi 0,8 mm. Qemeri i pajisur me 7 ylyqe dhe me nje llastik ne pjesen mbrapa per te krijuar nje rehati ne veshje. Ngjyra e pantallonave do te jete **E Verdhe floreshente**

Karakteristikat e tekstitiduhettejene:

Dendesia e bazes dhe indit $B= 282 +,-,2 \text{ f/10 cm}$; $I= 202+,-,2 \text{ f/10 cm}$
Qendrueshmeria e permasave $B= 1663 \text{ N}$ $\varepsilon =71\text{mm}$
Percaktimi i mases $394,2 \text{ g/m}^2$
Trashesia 0.72 mm
Lageshtira 5%
Rezistenca e ngjyres ne larje 40 grade C Nota 3
Percaktimi i hollesise se fillit $NmB=11.5/1$, $NmI=23.4/1$. Sarzh 2/1.

3) Cizmellastiku

Çizmegome me ngjyre**bluosejeshile** me përbërje 100% polivinilklorid (PVC) me njështrësëtekstili push nëanën e brendshme, gjatësia e çizmesderinëkupën e gjurit ,epadepërtueshmenjavaji, me shollë me lule. Material i sholles sitentik i patentuar. Lartesia e çizmes duhet te 33(ne varesi te mases). Lartesia e sholles perpara 1.6 cm dhe ne thember 3 cm. Te jene te prodhuar me PVC. Ti rezistojne ndryshimit te temperatures se ambientit te punes. Te jene te pershtatshme per te punuar ne ambiente me prezence te vajrave lubrifikante, karburanteve, etj. Ngjyra e çizmeve te jete blu ose jeshile Cilesia e larte. Prodhimi i çizmeve te jete bere jo me pare se tre muaj nga koha e levrimit.

4) Jelekfosforeshent (me logo)

Jelek material poliester, veshjepunereflektivefosforeshente medyshiritaperrethdhedyshiritaverikalsupeve, per njeparaqitjetelarte ne pune,

rezistentendajujitdhetemperaturaveteulta, praktikeprofesionale e modern.Sipasdirektives EN 340te mbrojtjesdhesigurise ne pune. Me etiketen e firmes prodhuese te trpezuar per udhezimin e perdorimit. **Ngjyra e verdhe**. Ne pjesen e kurriz te stampohet logoja e ndermarrjes

5) Perparese(me logo)

Materiali 35% pambuk dhe 65% poliester,tekstil,i tezgjahur,me thurje sarzh 2/1,cilesia e larte. Te kete jake, hapje para dhe mbërthimi me percina ne forme unaze me gjersi 1 cm. Ne pjesen e perparme te saj te kete dy xhepa dopjo pllak dhe siper nje xhep ne krahun e majte. Bluzat te jene me mende te gjata. Ne xhepin e majte lart dhe ne pjesen e kurriz te stampohet logoja e ndermarrjes

Ngjyra:Jeshile

Masa m²: 245± 10 gram

Trashësia: 0.44 ±0.05mm

Lageshtira : 2.1 %

Qëndrueshmëria e ngjyrës në larje 60°C: Nota 4-5

Thurja: Sarzh (diagonal) 3/1

Përbërja fibrore: 35 % Pambuk + 65 Poliester

Dendësia e bazes dhe indit B= 514 +,-,2 f/10 cm; I= 242+,-,2 f/10 cm

Qendrueshmeria dhe elasticiteti B= 1463 N ε=45mm,ne keputje sipas bazes dhe inditI =827 Nε = 35mm

Precaktimi i hollesise se fillit NmB=36.5/1 ,NmI=28.7/1

6) Kominoshe verore

Kominoshet te jene verore me rripa, me dy xhepa anesore dhe nje xhep me zinxhir ne pjesen e gjoksit.

Materiali 35% pambuk dhe 65% poliester,tekstil,i tezgjahur,me thurje sarzh 2/1,cilesia e larte

Ngjyre: e Verdhe floreshente

Masa m²: 210± 10 gram

Trashësia: 0.44 ±0.05mm

Lageshtira : 2.1 %

Qëndrueshmëria e ngjyrës në larje 60°C: Nota 4-5

Thurja: Sarzh (diagonal) 3/1

Përbërja fibrore: 35 % Pambuk + 65 Poliester

Dendësia e bazes dhe indit B= 514 +,-,2 f/10 cm; I= 242+,-,2 f/10 cm

Qendrueshmeria dhe elasticiteti B= 1463 N ε=45mm,ne keputje sipas bazes dhe inditI =827 Nε = 35mm

Precaktimi i hollesise se fillit NmB=36.5/1 ,NmI=28.7/1

7) Kominoshe dimerore

Tekstil i gomuar (mos pershkueshmeria e ujit 100%)

Ngjyra: E Verdhe floreshente

Masa m²: 180 ± 10 gram

Trashësia: 0.3 ± 0.05 mm

Qëndrueshmëria e ngjyrës në larje 30°C: Nota 5

Thurja : Garniturë Përbërja fibrore: 62 Polyester + 38% Polyamid.

Pjesa e brendshme me mbushje me vatine 0.5 cm, 100% poliester

8) Bluzaverore

Bluze verore me tre kopsa, tip polo

100% pambuk

Masa: 180 gr/m²

Thurja: trikotazh

Ngjyra: E Verdhe

9) Xhup pune me logo

Materialet qe duhet te perdoren per prodhimin e artikullit “Xhup pune” jane:

Lenda e I-re , tekstil impermeable, i gomuar ngjyre blu dhe e verdhe tekstil tezgjahu,100 % waterproof (kundra ujit), cilesia e I-re me keto te dhena:

- Ngjyra blu dhe e verdhe

- Perberja polyamide(PA 6.6) me polyuretan (PU)

- Thurja garniture

- Masa gr/m² 180 +/- 8 gr

Qendrueshmeria ndaj grisjes: ne baze 120N±5% ne ind 120N±5%

Qendrueshmeria ndaj keputjes: ne baze 1680N±5% ne ind 1680N±5%

- Numri metrik ne baze filament 1000 Dtex ne ind 1000 Dtex

- Trashesia e tekstili 0.60 mm - 0.80 mm

- Qendrueshmeria ne ferkim mbi 20000 cikle

- Qendrueshmeria e ngjyres Nota 4 - 5

- Qendrueshmeria e ngjyres duhet te jete me note 4-5 ne gjendje te thate, njome, ne larje

me solucion, me sapun, etj

Shkurtimi pas 5 larjesh: $\leq 2\%$

Materialet ndihmese qe duhet te perdoren per ndertimin e artikullit “ Xhup pune ” jane:

Astar me fiber natyrale ose viskoze me ngjyre blu se bashku me filter te qepur ne forme rombi.Zinxhir konfeksioni

Butona metalik mashkull-femer

Penj qepje te zinj 80/2 sipas llojit te materialit

Cilesia e tegelit: uniforme dhe pa defekte ne siperfaqe

10)Sapunaaromatik

Sapun aromatik 125 gr, cilesore.

11) Doreza

Trashësia: 0,6 –0,8 mm

Qëndrueshmëria e ngjyrës: Nota 4

Hyrja në ujë: 0

Përbërja: 35% pambuk+ 35% polyester+ 30% polyretan

Thurja: Garniture

Masa g/m²: 300 ±10

Pjesa e jashtme e pellembes se dores dhe e gishterinjve do te jete e gomuar, pjesa e brendshme dhe ajo e jashtme qe mbetet do te jene beze pambuku. Doreza do te kete edhe pjesen tek kyçi me gjeresi 6 cm me perberje pambuk i thurur elastik.

12) Këpuce pune

Këpuçë me qafë, me mbrojtëse metalike, prodhuar nga lëkurë ngjyrë e zezë, rezistente ndaj vajrave, acideve dhe absorbimit të ngarkesave elektrike. Këpuçët të jenë të pajisura me shtresë metalike (përforcim mbrojtës) në pjesën e mesme të tabanit të këpuçës dhe pjesën e përparme duke i ofruar këmbës një mbrojtje maksimale kundër dëmtimeve gjatë punës me gozhdë, vida dhe peshave të ndryshme që mund të bien mbi këmbë, prodhuar sipas standartit CE EN 20345-1 S1P. Këpuçët të plotësojnë standartet europiane të vlefshme për këpuçët e sigurisë dhe profesionale.

- Lartësia: 14 cm
- Ngjyra: E Zeze
- Materiali: Lëkurë
- Rezistente ndaj nxehtësisë: Po
- Rezistente ndaj vajrave: Po
- Rezistente ndaj acideve/alkalineve: Po
- Rezistente ndaj rrëshqitjes: Po
- Mbrojtje nga elektriciteti: Po
- Mbrojtje nga goditjet: Po
- Rezistente ndaj ujit: Po

Faqja e këpuçës do të realizohet në pesë pjesë (një syprinë, dy faqe, një përforcues dhe një gjuhëz) të bashkuar mes tyre nga qepje me makinë. Qepja duhet të realizohet sipas modelit “tipi klasik me lidhësa dhe majë të gjërë”. Lëkura e përdorur duhet të jetë lëkurë e ngjeshur, e marrë nga pjesët më të mira, të regjura në krom, ngjyrë e zezë ose kafe dhe me trashësi 1.8-2.00 mm.

- Këpuçë me qafa me shollë gome të dhëmbëzuar me fortësi 75° Shore
- Përmbajtja e yndyrës: 7%
- Qëndrueshmëria në tërheqje: 2.5kg/mm²
- Qëndrueshmëria në fërkim: shumë e mirë
- Qëndrueshmëria e ngjitjes: me termofiksim
- Regjia: shumë e mirë
- Trashësia: 0.9 -1 mm
- Depërtueshmëria e avujve: 1mg/cm²

Treguesit Fiziko-Kimik (mbas provave në laborator)

- Regjia e lekurës të jetë shumë e mirë.
- Ngjyrosja jo me pak se nota 8-10.
- Plasaritja jo me pak se 1.55 kg/mm².

- Qëndrueshmëria e faqës gjatë tërheqjes jo me pak se 2.5 kg/mm². □0.2
- Të jenë rezistuese ndaj temperaturës dhe lagështirës jo më pak se 240 minuta.
- Qëndrueshmëria e shollës në gradë shore jo me pak se 75° Shore
- Rezistenca në shqitje e gomës jo me pak se 30 N (njuton).
- Fortësia e fitilit jo më pak se 1000 g

KUJDES

Specifikimet teknike nuk duhet të kenë asnjë kërkesë apo referencë të ndonjë markë apo emër i veçantë, patentë, vizatim ose tip, origjinë specifike, prodhues ose sipërmarrës shërbimi, përveç rasteve kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme, e përshkrimit të kërkesave, me kusht që fjalët “ose ekuivalent” të përfshihen detyrimisht në këto specifikime.

Shtojca 10

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

SASIA DHE GRAFIKU I LËVRIMIT

Sasia e mallit që kërkohet:

NR	Objekti i kontratës	SASIA	AFATET E LEVRIMIT	VENDI	MJETI
1	Blerje veshje pune	Sipas tabelës bashkalidhur DST	15 dite nga data e lidhjes se kontrates	Në magaz. e N.K.Plazh	Me mjetet e furnizuesit

Shtojca11

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor në Marrëveshjen Kuadër]

**PLANIFIKIMI I
KONTRATAVE NË MARRËVESHJEN KUADËR**

<input type="checkbox"/> Mall: Numri total i kontratave sipas Marrëveshjes Kuadër _____		
Kontrata Nr.	Titulli i Kontratës	Përshkrim i shkurtër i kontratës
01	_____	_____
02	_____	_____
03	_____	_____
...	_____	_____

Shtojca12

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

NJOFTIM STANDARD PËR OFERTUESIN E SKUALIFIKUAR³

[vendi dhe data]

[emri dhe adresa e autoritetit kontraktor]

[Adresa e ofertuesit]

I/E Nderuar, Z/Zj. <emri i kontaktit>

Ju falenderoj për pjesëmarrjen në procedurën e lartpërmendur të prokurimit publik. Procedura e kryer në përputhje me Ligjin nr. 9643 datë 20.11.2006, Për Prokurimet Publike.

Oferta juaj u vlerësua me kujdes sipas kushteve dhe kërkesave të përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e ofertës. Me keqardhje ju informoj se u s'kualifikuat sepse oferta e dorëzuar nga ju u refuzua për shkak të arsyes (-ve) së/të mëposhtme:

Nëse mendoni se Autoriteti Kontraktor ka shkelur LPP ose RrPP gjatë procedurës së prokurimit publik, atëherë keni të drejtë të filloni një procedurë rishikimi siç parashikohet në Kreun VII të LPP-së.

Edhe pse nuk mundëm të përdornim shërbimet tuaja në këtë rast, besoj se do të vazhdoni të jeni i interesuar në nismat tona të prokurimit.

Me respekt

< Emri >

³ Ky njoftim duhet të përdoret në rastin e procedurave të prokurimit që zhvillohen në rrugë shkresore

Shtojca 13

[Shtojcë për tu plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

FORMULARI I NJOFTIMIT TE FITUESIT

[Data]

Për: [Emri dhe adresa e ofertuesit të shpallur fitues]

Procedura e prokurimit:

Numri i referencës së procedurës/lotit:

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [Sasia ose qëllimi dhe kohëzgjatja e kontratës]

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojme se, kane qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. _____
Emri i plotë i shoqërisë _____ numri i NIPT-it _____
Vlera _____
(me numra dhe fjalë)

2. _____
Emri i plotë i shoqërisë _____ numri i NIPT-it _____
Vlera _____
(me numra dhe fjalë)

Etj. _____

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

1. _____
Emri i plotë i shoqërisë _____ numri i NIPT-it _____
2. _____
Emri i plotë i shoqërisë _____ numri i NIPT-it _____

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë [emri dhe adresa e ofertuesit të shpallur fitues] se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej [shuma përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra]/pikët totale të marra [_____]është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë [emri dhe adresa e autoritetit kontraktor dhe referenca e kontaktit] sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda _____ ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, kontrata do t'i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej [vlera përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra], siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë _____

Ankesa: ka ose jo _____

(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë _____

[Titullari i autoritetit kontraktor]

Shtojca 14

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor në rastin e marrëveshjes kuadër]

FORMULARI I NJOFTIMIT TË OPERATORËVE EKONOMIKË TË SUKSESSHËM NË MARRËVESHJEN KUADËR

[Data]

Për: [Emri dhe adresa e operatorëve ekonomikë të shpallur fitues]

1. _____

2. _____

3. _____

* * *

Procedura e prokurimit: _____

Numri i referencës së procedurës/lotit:

Përshkrim i shkurtër i kontratës: *[Sasia, objekti , kohëzgjatja e kontratës etj]*

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: oferta ekonomikisht më e favorshme çmimi më i ulët

Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këta operatorë ekonomikë, me shumatorën e çmimeve për njësi të ofruar/ me vlerat përkatëse të ofruara:

1. _____

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/vlera _____

(me numra dhe fjalë)

2. _____

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/vlera _____

(me numra dhe fjalë)

Etj. _____

Janë skualifikuar operatorët ekonomikë të mëposhëm:

1. _____

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

2. _____
Emri i plotë i shoqërisë _____ *numri i NIPT-it* _____

Perkatësisht për arsyet e mëposhtme:

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë se janë identifikuar si operatorë ekonomikë të suksesshëm:

1. _____
Emri i plotë i shoqërisë _____ *numri i NIPT-it* _____

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/Vlera _____/Pikët totale të marra _____
(me numra dhe fjalë)

2. _____
Emri i plotë i shoqërisë _____ *numri i NIPT-it* _____

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/Vlera _____/Pikët totale të marra _____
(me numra dhe fjalë)

Etj.____

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqiteni pranë [*emri dhe adresa e autoritetit kontraktor dhe referenca e kontaktit*], brenda _____ ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi për të lidhur draft marrëveshjen.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë _____

Ankesa: ka ose jo _____
(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë _____

[Titullari i autoritetit kontraktor]

Shtojca 15

KUSHTET E PËRGJITHSHME Mallrat –Kërkesë për propozim

Neni 1: Qëllimi

- 1.1 Këto kushte të përgjithshme të kontratës (KPK) do të zbatohen për blerjen e Mallrave të prokuruarra me anë të procedurës me negociim.
- 1.2 Ligji për Prokurimin Publik në Republikën e Shqipërisë parashikon se dispozitat e Kodit Civil Shqiptar do të zbatohen për kontratat e prokurimit publik. Disa dispozita të Kodit Civil janë rishprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e kushteve të kontratës. Megjithatë, citimi i disa dispozitave këtu nuk mohon në asnjë mënyrë zbatimin e dispozitave të tjera të Kodit Civil të kësaj kontrate.
- 1.3 Në mënyrë të ngjashme, disa dispozita të Ligjit mbi Prokurimin Publik janë rishprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e ligjit që rregullon prokurimin publik. Megjithatë, citimi i disa dispozitave këtu nuk mohon në asnjë mënyrë zbatimin e dispozitave të tjera të Ligjit mbi Prokurimin Publik mbi të drejtat, detyrat dhe detyrimet e palëve.
- 1.4 KPK do të zbatohen deri në atë masë që të mos lënë mënjanë kushtet ose dispozitat e paraqitura në pjesë të tjera të kontratës.
- 1.5 Kushtet e kontratës përfshijnë gjithashtu Kushtet e Veçanta të Kontratës (KVK). Në rast se ka një konflikt midis KPK dhe KVK, KVK do të mbizotërojnë mbi KPK.

Neni 2: Përkufizime

- 2.1 “kontratë” do të thotë marrëveshja e shkruar e lidhur midis Autoritetit Kontraktor dhe Kontraktuesit që përbëhet nga Dokumentat e Tenderit duke përfshirë KPK dhe KVK, të gjitha shtojcat dhe formularët e plotësuar dhe të gjitha dokumentat e tjera që përfshihen në referimin e çdo dokumenti.
- 2.2 “çmim kontrate” do të thotë çmimi që i paguhet Kontraktuesit sipas kontratës për zbatimin e plotë dhe të përpiktë të detyrimeve të tij kontaktore.
- 2.3 “Incoterms” do të thotë termat ndërkombëtare tregtare që përbëjnë rregullat e interpretimit të termave tregtare që përcaktojnë detyrimet përkatëse, kostot, dhe risqet e lidhura me transferimin e Mallrave nga shitësi tek blerësi.
- 2.4 “Lëvrimiti” do të thotë të gjitha aktivitetet dhe veprimet që mundësojnë marrjen e Mallrave në vendin e shpërndarjes siç specifikohet në kontratë si paketimi, transportimi, sigurimi, tarifat, procedura doganore, ngarkimi dhe shkarkimi, instalimi, mbledhja, bashkimi, kontrollimi i veprimeve dhe mbikëqyrja e gjithë kësaj veprimtarie.

- 2.5 “Autoriteti Kontraktor” do të thotë Autoriteti Kontraktor që është pjesë e kësaj kontrate dhe sipas dispozitave të kësaj kontrate blen Mallrat. Ky term kudo që përdoret ka kuptim të njëjtë me atë të perkufizuar në ligj.
- 2.6 “Kontraktues” do të thotë personi fizik ose juridik që është palë e kësaj kontrate dhe sipas dispozitave të kësaj kontrate furnizon Mallrat.
- 2.7 “Palë (t)” do të thotë nënshkruesit e kontratës.
- 2.8 “Mallrat” do të thotë materialet e papërpunuara, produktet, makineritë dhe pajisjet, objektet në formë të ngurtë, të lëngshme ose të gaztë.
- 2.9 “Shërbimet e lidhura me to” do të thotë shërbimet ndihmëse ose të paparashikuara të furnizimit të Mallrave, si transportimi, instalimi, mirëmbajtja, trajnimi, shërbimet mbështetëse ose detyrime të ngjashme në lidhje me furnizimin e Mallrave.
- 2.10 “Objekt i kontratës” do të thotë të gjitha Mallrat dhe Shërbimet e lidhura me to që Kontraktuesi do të sigurojë sipas kushteve të kontratës.
- 2.11 “Standarde Teknike” do të thotë specifikimet e aprovuara nga një organ i posaçëm standardizimi për zbatimin e vazhdueshëm ose të përsëritur. Standarde të tilla përdoren si rregulla, rregullore ose perkufizim të karakteristikave për të siguruar se materialet dhe shërbimet e procesuara i përgjigjen qëllimit.

Neni 3: Hartimi i Kontratës

- 3.1 Njoftimi i ofertës fituese do të shërbejë për hartimin e kontratës midis palëve, e cila duhet të firmoset brenda afatit të parashikuar në Dokumentat e Tenderit.
- 3.2 Egzistenca e kontratës do të konfirmohet me nënshkrimin e dokumentit të kontratës duke trupëzuar të gjitha marrveshjet midis palëve.

Neni 4: Praktikat e Korrupsionit, Konflikti i Interesit dhe Kontrolli i Procesverbaleve

- 4.1 Autoriteti Kontraktor mund t’i kërkojë gjykatës të deklarojë të paligjshme kontratën nëse zbulon se Kontraktuesi ka kryer veprime korruptive. Veprimet korruptive përfshijnë veprimet e përshkruara në Nenin 26 të Ligjit mbi Prokurimin Publik.
- 4.2 Kontraktuesi nuk duhet të ketë lidhje (të tashme ose të shkuara) me asnjë konsulent ose ndonjë ent tjetër që ka marrë pjesë në përgatitjen e Dokumentave të Tenderit për këtë prokurim.
- 4.3 Kontraktuesi duhet të lejojë Autoritetin Kontraktor të inspektojë llogaritë dhe regjistrat që kanë lidhje me zbatimin e kontratës ose t’i kontrollojë ato me anë të kontrollorëve të emëruar nga Autoriteti Kontraktor.

Neni 5: Informacioni Konfidencial

- 5.1 Kontraktuesi dhe Autoriteti Kontraktor duhet të mbajnë në konfidencë të gjitha dokumentat, të dhënat dhe informacionet e tjera të dhëna nga pala tjetër në lidhje me kontratën.

- 5.2 Kontraktuesi mund t'i japë nënkontraktuesit dokumenta të tilla, të dhëna ose informacione të tjera që merr nga Autoriteti Kontraktor deri në masën e kërkuar për nënkontraktuesin të kryejë punën e tij sipas kontratës. Në rast të tillë, Kontraktuesi duhet të përfshijë në kontratën e tij me nën-Kontraktuesin një dispozitë që parashikon ruajtjen e konfidencialitetit siç thuhet në Paragrafin 5.1 më sipër.

Neni 6: Pronësia Intelektuale

- 6.1 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, të gjitha të drejtat e pronës intelektuale të siguruar nga Kontraktuesi gjatë zbatimit të kontratës do t'i përkasin Autoritetin Kontraktor i cili mund t'i përdorë ato sipas gjykimit të tij.
- 6.2 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, Kontraktuesi, pas përfundimit të kontratës, duhet t'i parashtojë Autoriteti Kontraktor të gjitha raportet dhe të dhënat si hartat, diagramet, skicimet, specifikimet, planet, statistikatat, llogaritjet dhe regjistrat mbështetës ose materialet e fituara, mbledhura ose përgatitura nga Kontraktuesi gjatë zbatimit të kontratës. Kontraktuesi mund të mbajë kopje të këtyre dokumentave dhe të dhënave, por nuk duhet t'i përdorë për qëllime që s'kanë lidhje me kontratën pa leje paraprake me shkrim nga Autoriteti Kontraktor.
- 6.3 Kontraktuesi duhet të shkarkojë Autoritetin Kontraktor ngapërgjegjësia për shkelje të të drejtave të pronësisë intelektuale që mund të dalin nga prodhimi ose shpërndarja e Mallrave sipas kontratës.
- 6.4 Në rast se ngrihet ndonjë pretendim ose padi kundër Autoritetit Kontraktor në lidhje me ndonjë shkelje të pronësisë intelektuale të shkaktuar nga zbatimi i kontratës ose nga përdorimi i Mallrave të furnizuara sipas kontratës, Kontraktuesi duhet t'i japë Autoritetit Kontraktor të gjitha provat dhe informacionin në posedim të Kontraktuesit që kanë të bëjnë me këtë padi apo pretendim.

Neni 7: Origjina e Mallrave

- 7.1 Nuk ka asnjë kufizim për kombësinë e origjinës së mallrave, përveç atyre që mund të jenë përcaktuar në ndonjë Rezolutë të Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara.
- 7.2 Kontraktuesi mund të jetë i detyruar të verifikojë origjinën e mallrave.
- 7.3 Për qëllime verifikimi, "origjinë" do të thotë vendi ku mallrat janë nxjerrë, ose prodhuar. Mallrat janë prodhuar kur, nëpërmjet përpunimit, procesimit, ose mbledhjes së mjaftueshme të komponentëve, rezulton një produkt i ri i njohur në tregti që është mjaft i ndryshëm në karakteristikat bazë ose në qëllim apo përdorim nga komponentët e tij.
- 7.4 Origjina e mallrave ka dallim nga kombësia e Kontraktuesit ose nënkontraktuesit që siguron mallrat.

Neni 8: Qëllimi i Furnizimit dhe Përshtatshmëria e Mallrave me Specifikimet

- 8.1 Kontraktuesi duhet të dorëzojë Mallrat në përputhje me cilësinë, sasinë dhe llojine specifikuar në kontratë, si dhe të vendosura dhe paketuara në mënyrën e përcaktuar në kontratë.

- 8.2 Mallrat nuk janë në përputhje me kontratën, nëse ato nuk janë të përshtatshme për përdorimin e posaçëm të parashikuar në kontratë. Kur nuk është e mundur të përcaktohet një gjë e tillë, thuhet se Mallrat nuk janë në përputhje me kontratën nëse ato nuk janë të përshtatshme për përdorimin për të cilin shërbejnë zakonisht sendet e tjera të të njëjtit lloj.
- 8.3 Nëse shitja është bërë në bazë të një modeli ose kampioni, shitësi (Kontraktuesi) duhet të dorëzojë sendet që kanë të njëjtat cilësi si të modelit ose kampionit.

Neni 9: Përputhshmëria e Mallrave me Standardet Teknike

- 9.1 Mallrat e furnizuara sipas kontratës duhet të jenë konform kodeve dhe Standardeve Teknike të parashikuara në specifikimet teknike. Nëse gjatë ekzekutimit të kontratës, ka ndryshime në kodet përkatëse ose në Standardet Teknike, këto ndryshime do të zbatohen vetëm pas aprovimit nga Autoriteti Kontraktor.
- 9.2 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet nga ndonjë dispozite tjetër e kontratës, kur nuk është përcaktuar asnjë Standard Teknik përkatës në specifikimet teknike, Mallrat duhet të jenë konform Standardeve Teknike ndërkombëtare. Nëse nuk ekzistojnë Standarde Teknike ndërkombëtare, Mallrat duhet të jenë konform Standardeve Teknike përkatëse Shqiptare.
- 9.3 Kontraktuesi nuk mban përgjegjësi për gabime në skicim, të dhëna, vizatim ose çdo aspekt tjetër të specifikimeve teknike të dhëna nga Autoriteti Kontraktor me përjashtim të rastit kur gabimi ishte aq i dukshëm sa Kontraktuesi duhet ta kishte parë dhe këshilluar Autoritetin Kontraktor për të.
- 9.4 Shitësi (Kontraktuesi) nuk mban përgjegjësi për defekte të Mallrave për të cilat Autoriteti Kontraktor ishte në dijeni në momentin e lidhjes së kontratës ose nuk ishte në dijeni për faj të tij, me përjashtim të rastit kur defektet kanë të bëjnë me cilësinë e Mallrave të specifikuar sipas kontratës ose përfaqësimin e reklamës së shitesit (Kontraktuesit).

Neni 10: Pjesët e Këmbimit

- 10.1 Nëse është e parashikuar nëkontratë, Kontraktuesi duhet të përfshijë me Mallrat e lëvruara një sasi pjesësh këmbimi, në përputhje me specifikimet teknike dhe çdo dispozitë përkatëse të kontratës.
- 10.2 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe, pjesët e këmbimit do të dorëzohen bashkë me Mallrat.
- 10.3 Kontraktuesi duhet të garantojë disponueshmërinë e pjesëve të këmbimit për një periudhë të specifikuar në ofertën e tij dhe të barabartë me jetëgjatësinë e përdorimit të Mallrave.
- 10.4 Në rast të një vendimi të ndërprerjes së prodhimit të pjesëve të këmbimit, Kontraktuesi duhet të njoftojë Autoritetin Kontraktor brenda një kohe të arsyeshme/mjaftueshme për t'i lënë mundësi atijqëtë prokurojë sasi të mjaftueshme për përdorim të mëvonshëm.
- 10.5 Pas ndërprerjes së prodhimit të pjesëve të këmbimit, Kontraktuesi duhet t'i japëpa pagesëAutoritetit Kontraktor, nëse ai e kërkon, çdo prodhim, vegël, skicim të pjesëve të këmbimit të përdorura në prodhimin dhe mirëmbajtjen e Mallrave.

Neni 11: Ambalazhimi

- 11.1 Kontraktuesi duhet të dorëzojë Mallrat të vendosura dhe të ambalazuara në mënyrën e përcaktuar në kontratë.
- 11.2 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet nga ndonjë nen tjetër i kontratës, mund të thuhet se Mallrat nuk janë vendosur dhe paketuar në përputhje me kontratën nëse ato nuk janë vendosur dhe paketuar në të njëjtën mënyrë që bëhet zakonisht për gjërat e të njëjtit lloj ose, nëse mënyra e zakonshme nuk është e disponueshme, në një mënyrë që është e përshtatshme për ruajtjen dhe mbrojtjen e Mallrave.

Neni 12: Testimet dhe Inspektimet

